

VENDIM
Nr. 560, datë 8.10.2025

PËR LEJIMIN E PARAQITJES SË DOKUMENTEVE TË FONDIT ARKIVOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË EKSPOZITËN “DEMOKRACIA NËPËRMJET LIGJIT”, NË MJEDISET E *DOGE’S APARTMENTS AT PALAZZO DUCALE*, NË VENECIA, ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 83 e 84, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e paraqitjes jashtë shtetit, në ekspozitën “Demokracia nëpërmjet ligjit”, pranë muzeut “*Doge’s Apartments at Palazzo Ducale*”, në Venecia, Itali, për periudhën 11 tetor 2025 deri më 6 janar 2026, si pjesë e veprimtarive zyrtare në kuadër të përvjetorit të 35-të të Komisionit Evropian për demokracinë nëpërmjet ligjit, organizuar në bashkëpunim ndërmjet Zyrës Italiane të Këshillit të Evropës, Komisionit të Venecias, Superintendencës Arkivore dhe Bibliografike të Venetos dhe Trentino-Alto Adige-s, Arkivit Shtetëror të Venecias, fondacionit “*Musei Civici di Venezia*” dhe Këshillit Rajonal të Venetos, të dokumenteve të mëposhtme, pjesë e Fondit Arkivor të Republikës së Shqipërisë:

- a) ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (40 faqe);
- b) dekreti nr. 2241, datë 21.10.1998, i presidentit të Republikës, “Për shpalljen me referendum të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” (1 faqe);
- c) dekreti nr. 2260, datë 28.11.1998, i presidentit të Republikës për shpalljen e ligjit (1 faqe).

2. Dokumentet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi dërgohen jashtë dhe rikthehen brenda vendit në periudhën ndërmjet datave 1 tetor 2025 – 15 janar 2026, pas mbylljes së ekspozitës, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me postë diplomatike, korrier diplomatik.

3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të bashkërendojë me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama